

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: Blerje materiale për Ujësjiellës dhe KUZ

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
19511200-3, 31711400-7, 44163110-4.**

VLERA E FONDIT LIMIT: 32,000,000 (tridhjetë e dy milionë) lekë pa TVSH.

32,000,000 (tridhjetë e dy milionë) lekë pa TVSH ose 341,224.35 (treqind e dyzet e një mijë e dyqind e njëzet e katër presje tridhjetë e pesë) euro pa TVSH.

Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë më datë 08.07.2026 është 93.78
(nëntëdhjetë e tre presje shtatëdhjetë e tetë) lekë/euro.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Ujesjelles Kanalizime Kamez Sh.aka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

OFERTUESI DEKLARON SE:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik,

nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;

d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;

dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;

e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;

gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, **sipas Shtojcës 9.**

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimi nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, nenin 43 pika 2/a dhe nenin 47 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosija e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet është në përputhje me përcaktimet në nenin 43 pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar,

ku përcaktohet se Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet :a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar”. Në rastin konkret nga ana e Njësisë së Prokurimit

është konsideruar e arsyeshme që vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, nxitjen e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë si edhe të sigurimin e një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë ofertuesit e mundshëm ekonomikë. Marrë shkas nga fakti që referuar përcaktimit të bërë në nenin 43 pika 2/a, AK nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së përlllogaritur të vlerës së lotit në kërkesën për kualifikim, por në respektim të parimeve ligjore dhe në përmbushjen e qëllimeve të ligjit të prokurimit si më sipër cituar ka tagrin të kërkojë një vlerë më të ulët se dyfishi i vlerës së përlllogaritur të kontrates për përmbushjen e vlerës së xhiros minimale vjetore. Kjo vlere është kërkuar duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

***Shënim:** Nëse operatorët ekonomikë, arrijnë vlerën e xhiros minimale të kërkuar në këto DT, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar, kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2023, 2024, dhe 2025**, të konfirmuara me vulë pranë autoriteteve përkatëse (Administratës Tatimore), dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të *ligjit Nr.10 091, datë 05.03.2009*, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e balanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht,

Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar. “

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).

Janë kërkuar vetëm bilancet e dy viteve financiare për ti mundësuar AK vlerësimin nëse OE ka një aktivitet pozitiv dhe garanton kështu realizimin me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se **40% e vlerës së fondit limit**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a.** Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses

të kontratës dhe faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

- b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar nën 40 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, ku përcaktohet se: “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.” Me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e ngjashme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Për të provuar aftësinë /përshtatshmërinë profesionale të OE, AK duke analizuar rast pas rasti bazuar në parimin e proporcionalitetit në objektin e kontratës që do të prokurohet, ka gjykuar të arsyeshme përcaktimin e kësaj vlere për të krijuar besueshmërinë e nevojshme në kapacitetet profesionale të OE.

Përcaktimi i vlerës së sipërcituar për furnizimet e mëparshme të ngjashme është një kriter i thjeshtësuar pranimit nga AK me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes dhe të Operatorëve të rinj në treg. Në këtë mënyrë AK krijon bindjen e përgjithshme në aftësinë profesionale të OE duke u bazuar në përvojat e mëparshme të tij realizuar në sektorin privat/publik për të marrë përsipër realizimin dhe zbatimin e objektit të kontratës që do të prokurohet.

2.3.2. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikata të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar akreditues, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në përputhje me objektin e prokurimit, si më poshtë:

- ISO 9001:2015 “Mbi sistemet e menaxhimit të cilësisë” (e vlefshme) ose ekuivalent;

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 1 të nenit 79 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, në të cilën gjejmë të përcaktuar se: 1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat e lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve

të kandidatit ose të ofertuesit. Ky kriter gjen mbështetje në piken 1 të nenit 44 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" ku përcaktohet se: 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, I plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organisma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe nëmënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit. Sa më sipër, ky kriter shërben për njohjen e kapacitetit të operatorëve ekonomikë ofertues dhe aftësinë e tyre teknike dhe profesionale për të furnizuar artikuj cilësorë dhe që janë prodhuar / vendosur në treg sipas standardit të sipërpërmendur.

ISO 9001 ose ekuivalent përcakton kërkesat për një sistem menaxherial të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të certifikohet nga çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit. (e nevojshme për objektin e prokurimit, të cilin AK kërkon të kryhet me cilësi dhe në kohë). Duke parë objektin e prokurimit, autoriteti kontraktor vlerëson të nevojshme të kërkojë që operatorët ekonomikë ofertues të jenë të pajisur me certifikata të cilësisë në përputhje me objektin e prokurimit, me qëllim që furnizimet të kryhen me cilësi sipas certifikatës ISO të mësipërme.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 88, pika 3, të VKM-së Nr. 285, datë 19.5.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, sipas të cilit: ". Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: **ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje**".

Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4. Operatorët ekonomikë duhet të dorezojnë : Operatori duhet të paraqesë jo më vonë se data dhe ora e hapjes së tenderit **mostrat** e materialeve të mëposhtme të cilat duhet të jenë sipas specifikimeve teknike:

Blerje tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=200 mm	1
Blerje tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=250 mm	1
Blerje tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=315 mm	1
Blerje tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=400 mm	1
Tuba ujesjellesi PE d=20mm, PN 10	1
Tuba ujesjellesi PE d=25mm, PN 10	1
Tuba ujesjellesi PE d=32mm, PN 10	1
Tuba ujesjellesi PE d=40mm, PN 10	1
Tuba ujesjellesi PE d=50mm, PN 10	1
Tuba ujesjellesi PE d=63mm, PN 10	1
Tuba ujesjellesi PE d=75mm, PN 10	1
Tuba ujesjellesi PE d=90mm, PN 10	1
Tuba ujesjellesi PE d=110mm, PN 10	1
Tuba ujesjellesi PE d=125mm, PN 16	1

Tuba ujesjellesi PE d=140mm, PN 16	1
Tuba ujesjellesi PE d=160mm, PN 16	1
Tuba ujesjellesi PE d=20mm, PN 10	1
Tuba ujesjellesi PE d=25mm, PN 10	1
Tuba ujesjellesi PE d=32mm, PN 10	1
Tuba ujesjellesi PE d=40mm, PN 10	1
Tuba ujesjellesi PE d=50mm, PN 10	1
Tuba ujesjellesi PE d=63mm, PN 10	1
Tuba ujesjellesi PE d=75mm, PN 10	1
Tuba ujesjellesi PE d=90mm, PN 10	1
Tuba ujesjellesi PE d=110mm, PN 10	1
Tuba ujesjellesi PE d=125mm, PN 16	1
Tuba ujesjellesi PE d=140mm, PN 16	1
Kapak gize grile C 250, 70x40 cm per Puset shiu	1
Kapak gize grile C 250, 60x40 cm per Puset shiu	1
Kapak gize grile C 250, 40x40 cm per Puset shiu	1
	1

Mostrat duhet të dorëzohen jo më vonë se data dhe ora e hapjes së tenderit. Mos dorezimi i mostrave brenda afatit do të sjellë skualifikimin e operatorit pjesëmarrës.

Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës ose marrëveshjes kuadër, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar,

Njësia e Prokurimit gjykon se qëllimi i vendosur për paraqitjen e mostrave, është dhënia e mundësisë së autoritetit kontraktor, i cili është përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, të kryerjes së verifikimeve (ekzaminim, inspektim, testim) të mostrave të dorëzuar nga autoriteti kontraktor në rast se këto të fundit janë në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor të pasqyruar në specifikimet teknike të procedurës së prokurimit.

Theksojmë se mostrat për produktet e kërkuara më lart nuk janë të ekzagjeruara në numër dhe dorëzimi i tyre është i rëndësishëm për autoritetin kontraktor në funksion të verifikimit të përputhshmërisë së specifikimeve teknike me mostrat e dorëzuara me qëllim realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi si dhe duke vlerësuar rendesine e objektit të prokurimit.

2.4.1 Kerkese ne lidhje me mostrat:

Per zerat ne tabelen se mesiperme - Tuba HDPE SN8 te te gjitha permasave operatori ekonomik duhet te vertetoj me ane te dokumentacionit te ngarkuar ne SPE se keto tuba jane te prodhuar sipas Normes – EN13476 tipi B/ekuivalente ose sipas Standarteve Shqiptare “SSH” mbi konformitetin e standarteve evropiane per tubat ne perdorim te ujesjellsave civil si dhe bashkimet e ketyre tubave sipas normes EN 681-1 /ekuivalente ose sipas Standarteve Shqiptare “SSH” mbi konformitetin e standarteve evropiane. Operatori ekonomik duhet te vertetoj me dokumentacion ne SPE se disponon AUTORIZIM PRODHUESI ose DISTRIBUTOR I AUTORIZUAR te dedikuar per kete procedure prokurimi. Ne rastet qe Prodhuesi eshte subjekt qe ushtron aktivitetetin ne Republiken e Shqiperise duhet te vertetoj se disponon licence te posacme per te qene prodhues.

Per zerat ne tabelen se mesiperme-Tubat e ujesllesit nga zeri 1-21 te tabelës se artikujve, operatori ekonomik duhet te vertetoj me ane te dokumentacionit te ngarkuar ne SPE se keto tuba jane te prodhuar sipas Normes –EN 12201-2 /ekuivalente ose sipas Standarteve Shqiptare “SSH” mbi konformitetin e standarteve evropiane per tubat ne perdorim te ujesjellesave civil. Operatori ekonomik duhet te vertetoj me dokumentacion ne SPE se disponon AUTORIZIM PRODHUESI ose DISTRIBUTOR I AUTORIZUAR te dedikuar per kete procedure prokurimi.

Per zerat ne tabelen se mesiperme – Kapak Gize per permasat 70x40,60x40,40x40 operatori ekonomik duhet te vertetoj me dokumentacion ne SPE se disponon AUTORIZIM PRODHUESI ose DISTRIBUTOR I AUTORIZUAR te dedikuar per kete procedure prokurimi. Ne rastet qe Prodhuesi eshte subjekt qe ushtron aktivitetetin ne Republiken e Shqiperise duhet te vertetoj se disponon licence te posacme per te qene prodhues.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 44, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar,

2.4.2 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë certifikate konformiteti/Certifikim të vlefshëm sipas standartit EN1916:2002/AC:2008 ose ekuivalent,për prodhimin e tubave dhe pajisjeve të betonit.

Argumentimi: Ky kriter eshte vendosur ne perputhje me piken 1 te nenit 79 te Ligjit nr.162/2020 “Per Prokurimin Publik” i ndryshuar, ne te cilen gjejme te percaktuar se: 1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatatë lëshuara nganjë organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. Ky kriter gjen mbështetje ne piken 1 te nenit 44 te VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”ku percaktohet se: 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura

ngushtësisht dhe nëmënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit. Sa më sipër, ky kriter shërben për njohjen e kapacitetit të operatorëve ekonomikë ofertues dhe aftësinë e tyre teknike dhe profesionale për të furnizuar artikuj cilësorë dhe që janë prodhuar / vendosur në treg sipas standardit të sipërpërmendur.

2.5 Deshmi për fuqinë mesatare puntore të operatorit ekonomik :

Nje punesim mestar prej te pakten **3 (tre) persona** te cilet te jene 2 shofer dhe 1 automakinist, e dokumentuar kjo me vertetimin e pageses se sigurimeve shoqerore, shendetesore dhe tatimit mbi te ardhurat nga punesimi **(eSig25)**.

Per shoferet duhet të paraqitet :

- Leje drejtimin e lëshuar nga dega e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor
- CAP -Certifikate e Aftësisë Profesionale
- Kontrata e punes

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77,pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4,c të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2.6 Disponimi i mjeteve të meposhtme:

Nr.	Mjetet	Sasia	Gjendja
1	Mjet transporti me peshëmbajtje mbi 3.5 ton	2	Pronësi ose me qira
2	Kamion me vinc	1	Pronësi ose me qira

-Për mjetet e transportit duhet të paraqiten:ne rast se janë ne pronesi dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), certifikata e pronesise, certifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit dhe foto të mjetit ku të jete e dukshme targa e mjetit.

Kur mjetet janë me qera duhet të paraqitet :kontrata e qerave e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi, e shoqëruar me lejen e qarkullimit, certifikatën e pronesise, certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit foto të mjetit ku të jete e dukshme targa e mjetit.

➤ **Për mjetet e mësipërme OE duhet të paraqesë Çertifikatë për transportin e mallrave.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4/ç të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. AK për të siguruar që OE ka kapacitetet për transportin e mallrave objekt prokurimi ka kërkuar që OE të disponoj mjetet e mesipërme. Me qëllim realizimin e procedurës në kohë korrekte sipas kërkesave të AK. Ky kriter është vendosur si siguri, që operatori ekonomik do të kryejë shërbimin e transportit në kohë duke marrë parasysh se malli do të shpërndahet në vendndodhje të caktuara, konkretisht në 5(pesë) njësi zonale të ndryshme në territorin e Bashkisë Kamëz. Gjithashtu kamioni me vinc kërkohet nga autoriteti

për të transportuar tubat e betonit apo të ngjashme me to, në destinacionet e nevojshme ku duhet kryer furnizimi në pamundësi të një mjeti të tilla nga AK. Kërkesa për minimumi tre mjete është vendosur në propozicion me sasinë e mallit që kërkohej dhe vendodhjen e Autoriteteve Kontraktore përfituese. Është kërkuar që kapaciteti mbajtës të jetë minimumi 3.5 ton, duke marrë parasysh llojin e mallrave që do të transportohen, peshën dhe përmasat që kanë. Një mjet me kapacitet të tillë siguron që mallrat të transportohen të sigurt dhe pa dëmtime në vendndodhjet e kërkuara.

ARGUMENTIM I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE.

Argumentim: Në bazë të nenit të 36, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 15, pika 3/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Specifikimet teknike janë hartuar nga specialistë të fushës (inxhinierë përkatës) për objektin që prokurohet. Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar në parametrat e dhëna (si psh; për pusetat dhe kapakët e pusetave janë dhënë ato dimensione që ne na nevojiten sipas kërkesave të shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Kamëz) dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara si dhe janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Shënime:

Në zbatim të nenit 36 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në të gjitha rastet kur në dokumentet e tenderit përmendet “marka”, përfshihet termi “ose ekuivalenti i saj”.

Të gjitha dokumentet duhet të paraqiten të përkthyer në shqip dhe të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, apo dokumente të rreme dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Në rastin e ofertave nga ofertues të huaj, dokumentet e ofertës duhet të jenë të barasvlershme me dokumentet e kërkuara sipas përcaktimeve ligjore të fushës për llogaritjen e dokumenteve.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

